



AMBIENTI
KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

Ndërmarrja Publike Lokale
KRM "Ambienti" Sh.A. Pejë
Njësia Operative Pejë, Klinë, Istog.
Zyret Qendrore Adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE

"Ambienti" SH.A PEJË

NR 652
DATA 10.03.26

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, dhe rregulloren e brendshëm për rregullimin e procedurave te konkursit nr 3090 e datës 21.11.2025 Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh . A .Pejë me datë 11.03.2026, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Punëtor Fizik në Mbledhjen e Mbeturinave - 2 pozitë

Vendi punës : Istog

Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të caktuar 3 vite ndërsa puna provuese 6 muaj

Koeficienti i pagës : 2.3

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës:

1. Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave.
2. Mbledh mbeturinat dhe bën zbrazjen e kontejnerëve dhe mjeteve të tjera për hedhurina apo qeseve nga shfrytëzuesit e shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
3. Pas zbrazjes së kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vende të caktuara dhe të kujdeset për to.
4. Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
5. Është i obliguar të mbaj uniformën e ndërmarrjes dhe pajisjet e tjera të punës dhe mbrojtjes në punë (PPM).
6. Kryen punë bazuar në kontratën e punës por edhe punë tjera me urdhëresë të shoferit, kryepunëtorit, koordinatorit operativ dhe menaxherit operativ.
7. Për mosrespektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drjtëpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Të ketë njohuri për shkrim dhe lexim përparësi shkollimi fillor;
- Aftësi fizike dhe psikike të dëshmuar;
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit : Dokumentacioni duhet të dërgohet ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com

Data e për aplikim është nga 11.03.2026 deri me 26.03.2026 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.